

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A., me seli në rr. Donka Ushlinova nr. 2, Garitage Park, ndërtesa 1, kati 4, Sofje, Republika e Bullgarisë, përmes Shoqërisë së Avokatëve BONA FIDE Shkup, në seancën e mbajtur më datë 16.07.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A., me seli në rr. Donka Ushlinova nr. 2, Garitage Park, ndërtesa 1, kati 4, Sofje, Republika e Bullgarisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi ACTUAL I.T, teknologji informatike, sh.a., me seli në rrugën Ferarska 14, 6000 Koper, Kapodistria, Republika e Sllovenisë, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë takse administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 27.06.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A., me seli në rr. Donka Ushlinova nr. 2, Garitage Park, ndërtesa 1, kati 4, Sofje, Republika e Bullgarisë, me të cilin TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A., synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi ACTUAL I.T, teknologji informatike, sh.a., me seli në rrugën Ferarska 14, 6000 Koper, Kapodistria, Republika e Sllovenisë, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A është një shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me rregulloret e R. së Bullgarisë, me seli në rr. Donka Ushlinova nr. 2, Garitage Park, ndërtesa 1, kati 4, Sofje, R. e Bullgarisë.

TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A paraqet një pjesë përbërëse të Grupit TELELINK, i cili është i pranishëm përmes shoqërive të tij të varura në disa tregje gjeografike, në tregje të ndryshme relevante, duke përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor: Republika e Maqedonisë së Veriut, R. e Serbisë, R. e Bosnjës dhe Hercegovinës, R. e Kroacisë dhe R. e Sllovenisë, si dhe në tregun më të gjerë evropian përmes pranisë në R. e Bullgarisë, R. e Rumanisë dhe R.F. të Gjermanisë, si dhe në SHBA, i cili është kryesisht i pranishëm në tregun relevant të teknologjisë informatike dhe komunikimeve.

TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A është i pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut përmes një ndërmarrjeje të lidhur mbi të cilën ushtron kontroll të drejtpërdrejtë me 100% të pjesës - Shoqëria për shërbime profesionale dhe këshilluese TELELINK BIZNIS SERVISIS SHPKNPJ Shkup, me NUAS 7385986, me veprimtari kryesore - 46.500 - Tregti me shumicë me pajisje informatike dhe të komunikimit. TELELINK BIZNES SERVISIS GRUP SH.A në Maqedoninë e Veriut kryen tregtinë me shumicë me pajisje informatike dhe të komunikimit, e cila përfshin shitjen e produkteve telekomunikuese si dhe integrimin e sistemeve, serverëve, hapësirave ruajtëse (storage), pajisjeve hardware dhe pajisjeve të rrjetit (network) nga marka të ndryshme.

ACTUAL I.T, teknologji informatike, sh.a, është i pranishëm në tregun e konsulencës për pajisje dhe programe kompjuterike dhe menaxhimin e pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike.

ACTUAL I.T nuk ka shoqëri të lidhura direkt ose indirekt në tregun e Maqedonisë së Veriut.

ACTUAL I.T realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut lidhur me shërbimet ITS në atë mënyrë që ofron shërbime për një kompani bijë në R. e Maqedonisë së Veriut të Zavarovalnica SHA Lubjanë (SAVA OSIGURUVANJE SHA Shkup), si pjesë e një marrëdhënieje kontraktuale me shoqërinë mëmë (Zavarovalnica SHA Lubjanë) në R. e Sllovenisë për ofrimin e shërbimeve për shoqëritë e saj të lidhura në rajon.

Në pjesën e tregut të shërbimeve SAP, aktivitetet afariste të grupit ACTUAL I.T janë të kufizuara. Aktualisht, grupi ACTUAL I.T në fushën e SAP ofron shërbime për një shoqëri të lidhur të TAB d.d. nga Sllovenia, e cila është e pranishme në Maqedoninë e Veriut, në bazë të një kontrate dhe nuk vepron në mënyrë të pavarur. Shumicën e shërbimeve SAP i ofron përmes subjekteve të tjera juridike - partnerë të SAP.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,*

vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ